

D) Hyrja¹

“Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal dhe praktika gjyqësore përkatëse. Kuptimi i veprave penale të reja kundër mjedisit. Veçoritë metodike të hetimit dhe ndjekjes penale të veprave në këtë fushë. Standartet dhe praktikat e mira europiane Roli i Acquis Communautaire dhe i Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal”

24 Tetor 2023

Paneli në këtë aktivitet trajnues:

- Z. Darjel Sina², ekspert;
- Znj. Elvana Çiçolli³, ekspert;
- Znj. Lorena Çabej⁴, lehtësues.

Në këtë aktivitet trajnues morën pjesë 27 pjesëmarrës ndër të cilët 2 gjyqtarë, 16 prokurorë dhe 9 oficerë të policisë gjyqësore.

II) Çështjet e trajtuara dhe qëndrimet e mbajtura.

1) Kuptimi i mjedisit dhe parimet e legjislacionit mjedisor. Pasojat e krimit mjedisor. Kuadri ligjor penal në mbrojtje të mjedisit.

E drejta e mjedisit në planin ndërkombëtar ka marrë zhvillim të gjerë, për shkak të pranisë së faktorëve të riskut, sidomos të dëmit shumë të madh që shkakton ndotja e tij. Në lidhje me mjedisin përdoren disa përkufizime; përgjithësisht, pranohet se mjedis mund të konsiderohet gjithçka që na rrethon: *“përbërësit natyrorë: ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu”*.⁵

Ka dy qëndrime juridike përse i përket raportit mes mbrojtjes së mjedisit dhe të drejtave të njeriut. Sipas një qëndrimi, mbrojtja e mjedisit është parakusht që individit të gëzojë të drejtat dhe liritë e tij themelore. Ndërsa sipas mendimit të dytë, në mënyrë që të garantohet mbrojtja e mjedisit, duhet që individit të ketë dhe t'i garantohen disa të drejta të veçanta, si e drejta për të marrë informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje publike dhe për të patur akses në gjykatë, për çështjet mjedisore. Këto janë edhe tre shtyllat e Konventës së Kombeve të Bashkuara në lidhje me mjedisin (ndryshe, Konventa e Aarhusit) që njihet edhe si demokracia në çështjet e mjedisit.

Dy janë parimet kryesore që përshkojnë legjislacionin mjedisor. Parimi i parë, *“parimi i zhvillimit të qëndrueshëm”*, sipas të cilit e drejta e mjedisit është e fokusuar tek kontrolli i ndotjes

¹ Tema, Paneli, numri i pjesëmarrësve, çështjet e trajtuara;

² Gjyqtar në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë;

³ Gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit;

⁴ Ndhimës magjistrate në Gjykatën e Lartë”

⁵ pika 7, e nenit 5 të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar.

dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore brenda një kornize të zhvillimit të qëndrueshëm. Vetëm kur ky parim nuk realizohet kalohet tek parimi i dytë: “*ndotësi paguan*”⁶. Pra kur shkaktohet një ndotje në mjedis dhe nuk mund të parandalohet dëmi që rrjedh prej saj, atëherë ai që ka shkaktuar ndotjen, detyrohet të paguajë.

Ndotja që mund t’i bëhet mjedisit mund të shkaktojë pasoja negative në këto drejtime:

- a) mjedisore, si humbja e specieve të gjuajtura në mënyrë të paligjshme, shkatërrimi i ekosistemit ose habitatit nga veprimtaria e paligjshme;
- b) ekonomike, si humbja e të ardhurave të ligjshme nga bizneset apo mosmbledhja e taksave nga shteti;
- c) sociale, si efekte shëndetësore, p.sh., dëmtimi i shendetit që vjen nga ndotja toksike.

Mjedisi si një e mirë publike gëzon një mbrojtje të posaçme ligjore e cila fillon me Kodin Penal dhe vijon me një sërë ligjesh të posaçme.

Kodi Penal parashikon veprat penale në fushën e mjedisit në kreun IV të Pjesës së Posaçme të tij, nga neni 201 deri në nenin 207/ç, në të cilat janë normuar disa figura veprash penale.⁷ Një pjesë e madhe e dispozitave të Kodit Penal që parashikojnë veprat penale kundër mjedisit janë dispozita blanket apo referuese, pasi të referojnë te ligjet e posaçme. Zbatuesit eligjit, prokuroria ose gjykata, duhet t’i referohen këtyre ligjeve për të vlerësuar nëse jemi para kushteve të përgjegjësisë penale apo të asaj administrative. Rëndësi vendimtare në përcaktimin nëse fakti i ndotjes së mjedisit përbën shkelje/kundravajtje administrative apo vepër penale, merr veçanërisht shkalla e rëndësisë së pasojave të shkaktuara prej ndotjes.

Përmbushja e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Direktivës 2008/99/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian datë 19.11.2008 “*Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal*”, përcaktoi edhe ndryshimet e Kodit Penal me ligjin 44/2019.⁸ Ndryshimet ligjore të bëra në Kodin Penal synuan ricilësimin juridik të figurave të veprave penale, duke i bashkuar ato në një të vetme, duke ndryshuar përmbajtjen e disa dispozitave, si dhe duke normuar figura të reja veprash penale. Pas këtyre ndryshimeve në ligjin penal vërehet se sigurohet një mbrojtje më e veçantë juridiko-penale për secilin prej përbësve të mjedisit: ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna, në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu.⁹

Për efekt studimi mund të bëhen disa kategorizime të veprave penale kundër mjedisit të cilat janë: a) referuar llojit të mjedisit të prekur, duke i parashikuar si vepra që lidhen me ndotjen e ajrit, të ujit, të tokës;¹⁰ b) referuar llojit të ndotësit të mjedisit të përfshirë, si për shembull të

⁶ Neni 12 i ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar;

⁷ Neni 201 “ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës” neni 201/a “menaxhimi i mbetjeve”; neni 201/b “transportimi i mbetjeve”; neni 201/c neni “aktivitetet e rrezikshme”; neni 201/ç “materialët bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme”; neni 202/a “tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”; neni 202/b “dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore”; neni 207/a “braktisja e kafshës të shoqërimit”; neni 207/b “vrasja me dashje e kafshës së shoqërimit”; neni 207/c “keqtrajtimi i kafshës”; 10. neni 207/ç “Ndeshjet ndërmjet kafshëve”.

⁸ Ligji nr. 44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*”.

⁹ Pika 7, e nenit 5 të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

¹⁰ Ky kriter është përdorur pjesërisht në Kodin Penal dhe konkretisht në nenin 201 të Kodit Penal “*Ndotja e ajrit*” dhe në nenin 203, “*Ndotja e ujërave*”.

mbeturinave elektronike, vajrave, azbestit, etj;¹¹ c) referuar metodës të përdorur për kryerjen e krimit;¹² d) referuar shtrirjes gjeografike veprat penale mund t'i klasifikojmë si vepra mjedisore të brendshme, kur ndodhin brenda kufijve shtetërorë, si dhe vepra mjedisore ndërkufitare.

Referuar kriterit të llojit dhe masës së dënimit të parashikuar veprat penale në fushën e mjedisit klasifikohen në krime apo kundravajtje penale.¹³

2) Problemet që janë hasur lidhur me kuptimin dhe zbatimin në praktikë të disa prej veprave penale në fushën e mjedisit.

Ndryshimet e Kodit Penal me ligjin 44/2019 kanë sanksionuar dy figura të reja të veprës penale që i referohen neneve 201/c dhe 201/ç, të cilat parashikojnë respektivisht veprat penale të “aktivitetit të rrezikshëm”¹⁴ dhe “*materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme*”.¹⁵ Çështja për diskutim që mund të lindë në praktikë për këto dy nene të Kodit Penal është nëse mund të ketë konkurrencë të këtyre veprave penale; p.sh., në rastin e funksionimit të një impianti, në kundërshtim me kërkesat ligjore, ku prodhohen, përpunohen, trajtohen, etj, materiale bërthamore apo substancave të tjera radioaktive të rrezikshme. Duke marrë në konsideratë faktin se janë dy figura të veprës penale, njëra e përgjithshme dhe tjetra e posaçme, që dallojnë nga mënyra e kryerjes së tyre, por që kanë objekt të njëjtë, ato nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën.¹⁶

Dispozita tjetër e shtuar është edhe neni 202/b i K.P i cili parashikon veprën penale të “*dëmtimit të habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore*”, vepër kjo që nga ana subjektive mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia ndërsa, nga ana objektive, mund të kryhet nëpërmjet veprimeve që shkelin kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente dhe që shkaktojnë përkeqësim të rëndë të një habitati, që ndodhet brenda një zone të mbrojtur mjedisore. Për shkak se veprimi i kësaj dispozite lidhet me një hapësirë të vecantë, “*zonë e mbrojtur mjedisore*”, lind problemi i përcaktimit të kësaj hapësire nëse koncepti “*zonë e mbrojtur*” i referohet konceptit të parkut kombëtar apo zona e mbrojtur është një zonë e përcaktuar me një vendim ose një zonë për të cilën është lëshuar një leje apo autorizim nga organet kompetente.

¹¹ Kriter ky i përdorur në nenin 201/ç “*Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme*”.

¹² Kriter ky i përdorur në nenet 204 “*Peshkimi i ndaluar*”, neni 206/a “*Shkatërrimi me zjarr i pyjeve*” apo dhe neni 207 “*Shkelja e karantinës së bimeve dhe kafshëve*”.

¹³ Krime ku të tilla janë veprat penale të “*ndotjes së ajrit, ujerave dhe tokës*” neni 201, “*menaxhimi i mbetjeve*” neni 201/a, “*transportimi i mbetjeve*” neni 201/b dhe “*shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor*” veçanërisht në rastet kur si pasoje e këtyre veprave kanë ardhur pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dhe kundravajtjeve penale ku të tilla janë veprat penale të “*peshkimit të ndaluar*” neni 204, “*prerja e paligjshme e pyjeve*” neni 205, “*prerja e drurëve dekorativë e frutorë*” neni 206, dhe “*shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve*” neni 207, duke u parashikuar si masë dënimi gjoba ose dënim me burgim deri në dy vjet.

¹⁴ Vepra penale “*aktivitete të rrezikshme*” parashikuar nga neni 201/c i referohet rasteve kur funksionon një impiant ku zhvillohet aktiviteti i rrezikshëm në të cilin mund të përdoren preparate të rrezikshme në shkelje të ligjit në fuqi apo në tejkalim të lejeve dhe licencave të dhëna.

¹⁵ Vepra penale “*materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme*” parashikuar nga neni 201/ç i referohet rasteve kur përdoren, prodhohen, përpunohen, trajtohen, ruhen, magazinohen materiale bërthamore apo substanca radioaktive të rrezikshme.

¹⁶ Qëndrim i mbajtur nga lehtësuese Lorena Çabej.

Çështjet në lidhje me problemet që paraqesin nenet 207/a¹⁷ dhe 207/c¹⁸ të Kodit Penal u bënë pjesë e diskutimit për shkak të shqetësimit dhe pyetjeve të ngritura nga njëri prej pjesëmarrësve lidhur me faktin se cila do të konsiderohet “kafshë shoqërimi” për efekt të zbatimit të kësaj dispozite.¹⁹ Parashikimit nga ligjvënësi në nenin 207/a “*braktisja e kafshës së shoqërimit*”, mban parasysh edhe zhvillimin dhe numrin në rritje të njerëzve që kanë dhe mbajnë kafshë në shtëpi, ndërkohë që qëllimi i një parashikimi të tillë është mosbraktisja, lënia në mëshirë të fatit të këtyre kafshëve. Pra, bëhet fjalë për kafshë që nuk konsiderohen të egra dhe që nuk mund të mbijetojnë në mjedis pa kujdesin e njeriut. Është e qartë se dispozita i referohet kafshës që shoqëron personat, por edhe çdo kafshe e cila mbahet në shtëpi (si mund të jetë rasti i reptilëve). Kjo është arsyeja pse braktisja e kafshës është parashikuar si vepër në nenin 207/a të Kodit Penal. Ky nen nuk gjen zbatim nëse kemi të bëjmë me kafshët e rrugës, pasi për to zbatohet neni 207/c i KP, që parashikon keqtrajtimin e kafshës dhe i cili u referohet kafshëve në tërësi, duke përfshirë edhe rastin e qenve e rrugës.²⁰

Gjatë aktivitetit u ngrit dhe pyetja se kur një qen shtëpiakdel pa dijeninë e pronarit nga dera e banesës dhe kafshon një kalimtar, cilësimi juridik i faktit do të bëhet si braktisje e kafshës së shoqërimit apo plagosje nga pakujdesia, në ngarkim të pronarit të qenit ? Ky diskutim mori shkak nga një rast praktik.²¹ Në rastin konkret fakti do të cilësohet si braktisje e kafshës së shoqërimit, parashikuar nga neni 207/a i Kodit Penal.²²

Një diskutim nga një rast praktik²³ lindi edhe për veprat penale në mbrojtje të pyjeve, në rastin e shoqërive private që kanë marrë leje minerare në një ekonomi pyjore, por Këshilli Bashkiak nuk ka marrë vendim për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes së marrë me leje minerare. Edhe në këtë rast problemi qëndronte në cilësimin e saktë juridik të faktit penal. Nga diskutimet dolën disa qëndrime lidhur me cilësimin juridik. Njëri qëndrim²⁴ e cilësonte faktin si “*shpërdorim i tokës*”, vepër kjo e parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal, duke marrë në përgjegjësi penale administratorin dhe personin juridik. Kryerja e veprës penale të shpërdorimit të tokës, ndodh në të gjitha ato raste kur me anë veprimeve aktive ndryshohet zëri kadastral i saj, p.sh., nga arë, ulishte në truall, pra, toka përdoret/shfrytëzohet në kundërshtim me destinacionin e saj. Për këtë arsye, cilësimi juridik i këtyre veprimeve të anës objektive mund të bëhet sipas veprës penale të parashikuar nga neni 199 i KP “*Shpërdorimi i tokës*”.

¹⁷ Neni 207/a “*Braktisja e kafshës së shoqërimit*”.

¹⁸ Neni 207/c “*Keqtrajtimi i kafshës*”.

¹⁹ Diskutime të hapura nga z.Eljo Mazreku, Prokuror në Prokurorinë e Tiranës.

²⁰ Qëndrim i mbajtur nga eksperte Elvana Çiçolli.

²¹ Në një rast të ndodhur në praktik, një qytetar paraqet kallëzim penal sepse ishte kafshuar nga qeni i fqinjit. Fqinji kishte një qen që e mbante për ruajtjen e shtëpisë, i cili del pa dijeninë e tij nga rrethimi i banesës dhe shkon kafshon fqinjin tjetër. Ky i fundit bën kallëzim për veprën penale të braktisjes të kafshës së shoqërimit, pasi kafsha, qeni në rastin konkret, konsiderohej i rrezikshëm edhe për të gjithë banorët e fshatit.

²² Qëndrim i mbajtur nga znj.Enkelelda Hoxha, Prokurore në Prokurorinë Kukës.

²³Në qarkun e Kukësit ka patur raste praktike ku kompani private që kanë marrë leje minerare për shfrytëzimin e kromit ose mineraleve të tjera në një ekonomi pyjore të caktuar dhe sipas dokumentacionit tekniko ligjor i vetmi element pengues për ushtrimin e aktivitetit të tyre është heqja nga fondi pyjor i sipërfaqes ku është dhënë leja e rregullt që e jep ministria e mjedisit. Ndërkohë që heqjen nga fondi pyjor e bën Këshilli Bashkiak, kompanitë fillojnë ushtrimin e veprimtarisë së tyre për shfrytëzimin e kromit ose mineraleve të tjera duke bërë hapje dhe gërmime, e prishur fondin pyjor dhe për këtë fakt janë kallëzuar në prokurori nga Bashkia.

²⁴ Qëndrim i mbajtur nga znj.Enkelelda Hoxha, Prokurore në Prokurorinë Kukës, z.Albert Kuliçi, Prokuror në Prokurorinë e Tiranës, Lehtësuese Lorena Çabej.

Qëndrimi tjetër²⁵ ka të bëjë me faktin se nëse personi, si pasojë e detyrimeve që burojnë nga leja e dhënë, ka bërë zëvendësim të pemëve të prera, duke mbjellë të njëjtën sasi dhe lloj peme të fondit pyjor në një vend tjetër, ai nuk mban përgjegjësi penale. Kjo ka të bëjë me parimin e "*restoration principle*", restauron atë që ke prishur, dëmtuar. Pra, e pranon dëmin dhe e zhdëmton atë nëpërmjet kthimit, rivendosjes së gjendjes së mëparshme. Megjithatë duhen marrë në konsideratë edhe detyrimet që rrjedhin nga leja e dhënë. Në këtë aspekt duhet parë edhe elementi subjektiv i veprës së prerjes së paligjshme e pyjeve, element që zhbëhet kur prerja e pyjeve ndodh si pasojë e ushtrimit të të drejtave që burojnë nga një leje e dhënë, e cila konsiderohet e mjaftueshme për kryerjen e aktivitetit, si dhe kur sasia dhe lloj i pemëve të prera të fondit pyjor, si pasojë e ushtrimit të aktivitetit të liçësuar, zëvendësohet me të njëjtën sasi dhe lloj peme duke i mbjellë në një vend tjetër. Pra, në rastin konkret ka shumë elemente që duhen parë, nuk është kaq e thjeshtë, por problemi bëhet më i vështirë për t'u zgjidhur.

Qëndrime të tjera lidhur me cilësimin juridik pati edhe kundrejt zbatimit në rastin konkret të nenit 202/b të Kodit Penal që parashikon "*dëmtimin e habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore*".²⁶

Në praktikë kanë lindur probleme edhe përsa i përket zbatimit të nenit 206 të Kodit Penal, "*prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë*".²⁷ Pyetja që lindi për këtë vepër ishte nëse paraparakisht bashkia ose pushteti vendor duhet të ketë një inventar të drurëve dekorativë apo frutorë me qëllim marrjen në përgjegjësi penale për këtë vepër? Përgjigja është që bashkia duhet të ketë një inventar, në të cilin të ketë të regjistruar të gjithë drurët pyjorë dekorativë apo frutorë që janë mbjellë në territorin e saj.²⁸ Megjithatë, edhe në rastin kur drurët dekorativë apo frutorë janë mbjellë nga persona privatë ato nuk mund të priten, pasi duke u bërë pjesë e mjedisit i përkasint gjithë publikut; për rrjedhojë, personi përgjegjës mban përgjegjësi penale në bazë të nenit 206 të Kodit Penal.²⁹

Situata ndryshon në rastin kur drurët dekorativë apo frutorë mbillen brenda oborrit të shtëpisë private. Në këtë rast zbatohen dispozitat e Kodit Civil dhe nuk kemi përgjegjësi penale. Në të drejtën civile bëhet dallimi i rasteve kur rrënjët dhe degët e pemëve bien në tokën e pronarit të tokës apo dalin jashtë saj. Në rastin e parë, nuk ka dyshim që pemët dhe frutat që bien nga pemët mbi tokë, i përkasint pronarit të tokës ku ato kanë rënë. Ndërsa në rastin e dytë kur degët e pemëve dhe rrënjët bien në tokën e finjit, ky i fundit pasi më parë t'i ketë kërkuar fqinjit që të presë degët e pemëve dhe rrënjët që i futen në tokën e tij, ka të drejtë t'i presë vetë ato, në rast se i sjellin dëm, si dhe të vjelë frutat dhe t'i përdorë ato për vete.

3) Çështja e parashikueshmërisë, kundërligjshmërisë dhe qartësisë ligjore të fakteve që përbëjnë vepra penale mjedisore. Përplasja dhe mbivendosja mes legjislacionit penal dhe atij administrativ.

Ekziston një mbivendosje e legjislacionit penal dhe atij administrativ, pasi shpeshherë veprat penale i referohen legjislacionit administrativ dhe mënyra se si janë formuluar këto

²⁵ Qëndrim i mbajtur nga eksperti Darjel Sina, z.Elio Mazreku, Prokuror në Prokurorinë e Tiranës.

²⁶ Qëndrim i mbajtur nga eksperte Elvana Çiçolli.

²⁷ Rasti praktik që u diskutua kishte të bënte me faktin kur një qytetar kishte mbjellë dy pemë frutorë përpara ballkonit të shtëpisë së tij në tokë publike. Kur pemët u rritën dhe u anuan u bënë problem për banorët përreth dhe qytetari kërkonte t'i priste ato.

²⁸ Qëndrim i mbajtur nga eksperti Darjel Sina.

²⁹ Qëndrim i mbajtur nga z.Albert Kuliçi, Prokuror në Prokurorinë e Tiranës.

dispozita penale tenton që të ndëshkojnë çdo veprim që i kundërdrejtohet mjedisit, kur këto elemente janë tej kufirit të normave të lejuara nga ligji për mbrojtjen e mjedisit apo ligjeve specifike. Por në këtë rast kufiri i normave të lejuara nuk parashikohet me ligj, por parashikohet me VKM, pra nuk kemi një kufi të normave të përcaktuara me ligj në kuptimin formal, por e kemi me akt nënligjor. Nëse do ta zgjerojnë interpretimin duke pranuar se pavarësisht se nuk është e parashikuar me ligj dhe është e parashikuar me akt nënligjor, që në konceptin formal nuk është ligj por është akt i autorizuar nga ligji, atëherë ky veprim do të ndëshkohet penalisht. Por nëqoftëse do të pranojmë se nuk ka një kufi të normave të përcaktuar me ligj, atëherë përfundimi mund të jetë që të gjitha këto procedime penale do të jenë jo të suksesshme³⁰, për shkak të cenimit të parimit të ligjshmërisë.

Po kështu në vijim të këtyre dispozitave ka disa terma ose koncepte të cilat janë të përgjithshme, të cilat nuk i përgjigjen të drejtës penale, e cila duhet të ketë koncepte të sakta dhe të qarta. P.sh., referuar nenit 201 të Kodit Penal që parashikon veprën penale të ndotjes së ajrit, ujërave dhe tokës, si rrethanë cilësuese e saj është parashikuar dëmtimi i rëndë i ekosistemit, biodiversitetit. Në këtë aspekt është e paqartë se kur do të ekzistojë kjo rrethanë cilësuese, pra çfarë përbën dëmtim të rëndë të ekosistemit apo të biodiversitetit.

Edhe kufiri i dëmit në mjedis që ndan dhe përcakton përgjegjësinë administrative nga ajo penale është i parashikuar me VKM dhe jo me ligj. Në disa raste dispozitat penale i referohen konceptit të dëmit të rëndë kur në asnjë ligj të posaçëm nuk është e përcaktuar se çfarë përbën dëm të rëndë. Ligji i posaçëm përcakton kuptimin e ndotjes, gazit, kimikatit, por nuk përcakton kuptimin e dëmit të rëndë apo edhe çfarë do të kuptojmë me sasi e papërfillshme.

Problem tjetër është që disa veprime të cilat i parashikojnë dhe i ndëshkojnë dispozitat penale, i parashikojnë dhe i ndëshkojnë administrativisht njëkohësisht edhe ligjet specifike, duke krijuar një mbivendosje mes legjislacionit penal dhe atij administrativ. P.sh., në nenin 40 të ligjit Nr. 27/2016 “Për menazhimin e kimikateve” është parashikuar se shkarkimet e azbestit në ajër ose derdhjet e tij në mjedis, në kundërshtim me vlerat kufi të parashikuara në legjislacionin specifik, përbën kundravajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 1 milion lekë deri në 2 milion lekë, ndërkohë që një fakt i tillë do të përbëjë edhe veprën penale të ndotjes së ajrit, ujërave dhe tokës, parashikuar nga neni 201 i KP³¹.

Pra, prokurori në punën e tij e ka shumë të vështirë të ndajë kufijtë e përgjegjësisë në rastet e mbivendosjeve mes ligjit penal dhe ligjit administrativ³².

4) Ekspertiza tekniko-mjedisore si një mjet prove i nevojshëm për konstatimin dhe sqarimin e fakteve penale mjedisore. Problematika e hasur në praktikën gjyqësore lidhur me ekspertizën tekniko-mjedisore.

Një problematikë tjetër në hetimin dhe gjykimin e veprave penale mjedisore është mungesa e ekspertizës, edhe pse në çështjet mjedisore ekspertiza është thelbësore. Fakti nëse ndotja e ajrit, të ujërave dhe të tokës do të përbëjë shkelje/kundravajtje administrative, apo vepër penale varet nga rëndësia e pasojave të shkatuara prej ndotjes.

Një provë e rëndësishme në hetimin dhe gjykimin e vepres penale të “ndotjes së ajrit, të ujërave dhe të tokës” e parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal është akti i ekspertimit teknik, i cili përcakton nivelin e ndotjes së ajrit me anë të çlirimit të tymrave, gazrave toksike tej kufirit të

³⁰ Qëndrim i mbajtur nga eksperte Elvana Çiçolli.

³¹ Qëndrim i mbajtur nga ekspertre znj. Elvana Çiçolli.

³² Konstatim i eksperte Elvana Çiçolli.

normave të lejuara, norma këto të përcaktuara nga VKM nr. 803, datë 04.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”.

Nga një studim i bërë prej Komitetit Shqiptar të Helsinkit lidhur me hetimin dhe gjykimin e veprës penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal, pranë Prokurorisë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Krujë, rezulton se në 11 vendime të prokurorisë për mosfillim të procedimit penal apo pushim të çështjes, akti i ekspertimit tekniko-mjedisor është kryer kur furra e gëlqeres nuk ka qenë duke e ushtruar aktivitetin e saj, duke djegur lëndët djegëse. Në të gjitha rastet, aktet e ekspertimit për matjen e nivelit të ndotjes së ajrit nuk janë realizuar në të njëjtën datë që është konstatuar fakti, por pas disa ditësh apo javësh, kur ndotja është minimizuar për shkak të pushimit të veprimtarisë së furrës. Këto të dhëna krijojnë dyshime të arsyeshme se kjo praktikë tolerance mund të ketë qenë e qëllimshme. Mosrealizimi i aktit të ekspertimit tekniko-mjedisor gjatë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së furrave vlerësohet se ka ndikuar në moskonstatimin e njërës prej elementëve të anës objektive të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal, që kërkon që ndotja e ajrit të jetë tej kufirit të normave të lejuara.

Nëse akti i ekspertimit tekniko-mjedisor nuk mund të realizohet në momentin e konstatimit të shkeljes, do të jetë e rekomandueshme që organi procedues të vendosë kryerjen e eksperimentit konform neneve 176 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale.³³ Në kushtet e eksperimentit ose siç njihet ndryshe të riprodhimit të dukurisë në kushte të ngjashme, për aq sa është e mundur, gjendja në të cilën fakti ka ndodhur ose çmohet se ka ndodhur, mund të realizohet duke kryer matjet në mënyrë objektive dhe sa më afër realitetit, e nivelit të ndotjes³⁴.

Një rast i evidentuar është rasti i Prokurorisë së Elbasanit, e cila mbi bazë të kallëzimit të bërë nga banorët dhe Avokati i Popullit, që pretendonin ndotje të mjedisit tej normave të lejuara si pasojë veprimtarisë së shoqërisë “Kurum International”, kishte regjistruar procedim penal për veprën penale *ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës* në ngarkim të kësaj shoqërie dhe një shoqërie tjetër. Nga hetimi kishte rezultuar se subjekti “Kurum International” sh.a. ishte licencuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, duke u pajisur me lejet përkatëse edhe për depozita për magazinimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj. Në akt ekspertimin teknik të parë të kryer konkludohej se ndotja nuk ishte mbi normat e lejuara. Më pas është kryer një akt tjetër riekspertimi teknik, prej të cilit konkludohej se *“nga ndotjet e ujërave të shkarkimeve të quajtura ujëra leksiviate ose acide, pra kur këto ujëra nuk depurohen (pastrohen), kemi ndotje me ndikim tepër të lartë të ujërave sipërfaqësore, të ujërave nëntokësore dhe të tokës ose, e thënë ndryshe, prishje të ekuilibre të ekosistemeve natyrore, e për pasojë edhe të atyre njërëzore”*.

Gjyqtari i seancës paraprake të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në lidhje me këtë akuzë ka vendosur të pushohet procedimi penal. Gjykata ka arsyetuar që aktiviteti industrial në fushën e metalurgjikut ka 40 - 50 vjet që vazhdon dhe kjo ndotje është akumuluar dhe nuk mund të provohet që e kanë shkaktuar të pandehurit dhe për këtë arsye nuk jemi në kushtet që provohet përgjegjësia penale. Prandaj në kushtet që përgjegjësia është individuale është vendosur pushim i procedimit penal. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës ndërsa Gjykata e Lartë e ka prishur vendimin e Apelit Durrës dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim për shkaqe procedurale³⁵.

³³ Qëndrim i mbajtur nga lehtësuese Lorena Çabej.

³⁴ Raporti i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, dhjetor 2017.

³⁵ Duke arsyetuar se *“Gjykata e seancës paraprake mund t’ia nënshtrijë debatit gjyqësor vlerësimin për provat, vetëm përse i përket papërdoshmërisë apo pavlefshmërisë së këtyre provave, por jo faktit nëse këto prova vërtetojnë apo jo fajësinë e të pandehurit, “Përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”. Kjo detyrë funksionale i takon Gjykatës së themelit.”*

5) Çështjet mjedisore nga këndvështimi i gjykimeve administrative

Gjykatat administrative kanë përpunuar praktikën dhe jurisprudencën e tyre, duke e lidhur të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore me interesin e tij të ligjshëm. Sipas këtij interpretimi kërkohet që individi të provojë përpara gjykatës që atij i është shkaktuar një dëm ose që ka mundësi t'i shkaktohet një dëm nga veprimet e paligjshme të subjekteve të ndryshme që shkaktojnë ndotje mjedisore, apo kur individi pretendon se atij i është cenuar e drejta e aksesit në informacionin mjedisor apo edhe në vendimmarrjet mjedisore.

Si kriter i përcaktimit të legjitimitetit aktiv është përdoruar kriterit i banimit, bazuar jo vetëm në të dhënat e gjendjes civile, por edhe në provat se ku jeton realisht personi³⁶ që paraqet padinë dhe kërkon fillimin e gjykimit.

Lidhur me çështjen e legjitimitetit aktiv një argument interesant është ndeshur në rastet kur objekti i gjykimit kanë qenë zonat e mbrojtura apo parqet kombëtare, ku në këto gjykime individët i janë drejtuar gjykatës në mbrojtje të parkut kombëtar, me pretendimin se legjitimoheshin të kundërshtonin ndërtimin e një veprë apo zhvillimin e një veprimtarie ekonomike me efekt në mjedis, pavarësisht nga fakti nëse ata banonin apo jo në atë zonë, me argumentin se parku kombëtar është pasuri kombëtare që u takon të gjithë individëve, qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.

Gjykatat administrative në rastet e çështjeve mjedisore përveç individëve kanë legjitimuar edhe shoqatat. Por ndryshe nga banorët, ku për legjitimitetin aktiv të tyre gjykatat kanë verifikuar territorin apo banimin apo vendqëndrimin e tyre, në rastin e shoqatave gjykatat për legjitimitetin aktiv të tyre i janë referuar statutit dhe akteve të regjistrimit të shoqatës. Për pasojë gjykatat nuk e kanë legjitimuar një shoqatë për të paraqitur padi për çështjet mjedisore nëse objekti i veprimtarisë së saj nuk i përkiste çështjeve mjedisore përkatëse. Nga praktika gjyqësore rezulton se të gjitha shoqatat që janë drejtuar gjykatave administrative kanë pasur në objekt të veprimtarisë së tyre çështjet mjedisore përkatëse, për të cilën ato janë drejtuar gjykatës dhe në këto kushte gjykata i ka legjitimuar.

Probleme të mëdha kanë lindur edhe me gjykimin e themelit të këtyre kërkesëpadive pasi si individët, por edhe shoqatat³⁷, në disa raste, kanë pretenduar se është shkaktuar një dëm ose ka mundësi të shkaktohet një dëm në mjedis, por duke mos e shoqëruar këtë pretendim me paraqitjen si provë të një ekspertize përkatëse. Kjo i ka sjellë vështirësi gjykatave në gjykimin e këtyre çështjeve, pasi dëmi në mjedis apo edhe mundësia e ardhjes së tij duhet të provohet prej paditësit përpara gjykatës nëpërmjet një ekspertize. Për këtë arsye, mungesa e saj, në disa raste, ka sjellë rrëzimin e padisë, pasi nuk është provuar që nga ushtrimi i kësaj veprimtarie do të vijë apo ka mundësi të vijë dëm në mjedis.

³⁶ Qëndrim i mbajtur nga eksperti znj. Elvana Cicolli;

³⁷ Rastet më të shpeshta të ndeshuara në praktikën gjyqësore administrative lidhur me shqyrtimin e çështjeve mjedisore kanë të bëjnë me gjykimin e kërkesë padive të iniciuara prej shoqatave për mbrojtjen e mjedisit apo banorëve të zonave ku veprojnë subjekte ekonomike prodhuese të cilat përpunojnë mbetje apo emetojnë ndotje në mjedis, ku nëpërmjet padive të paraqitura është kërkuar ndërprerja e veprimtarisë së këtyre njësive ekonomike prodhuese dhe zhdëmtimi i dëmit të pësuar.

Për sa i përket mosmarrëveshjeve që rrjedhin prej ndotjeve mjedisore, rëndësi të vecantë, përvec Konventës së Aarhusit, merr edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së, e cila në vendimet e saj, çështjet mjedisore i ka parë të lidhura me nenin 2 të KEDNJ-së, e drejta e jetës³⁸, me nenin 8 të KEDNJ-së, e drejta për jetë private dhe familjare³⁹, me nenin 6 të saj e drejta për proces të rregullt ligjor⁴⁰, me nenin 1 të Protokollit 1, e drejta e pronës⁴¹.

6) Përgjegjësia civile që rrjedh nga ndotja e mjedisit

Çështja e përgjegjësisë civile që rrjedh nga ndotja e mjedisit u bë pjesë e diskutimit të aktivitetit për shkak të shqetësimit dhe pyetjeve të ngritura nga njëri prej pjesëmarrësve lidhur me faktin nëse ka shteti shqiptar mjete ligjore për të mbrojtur civilisht bregdetin dhe ujrave tona detare nga ndotja që shkatojnë anije të huaja, që hedhin dhe shkarkojnë lëndë dhe substanca ndotëse në to? ⁴² Pyetjet dhe shqetësimet morën shkak edhe nga një rast i praktikës gjyqësore.⁴³ Në këtë aspekt, u diskutuan edhe kushtet dhe rrethanat kur kjo përgjegjësi i ngarkohet vetëm punonjësit konkret që ka kryer veprimin kriminal, si dhe kushtet dhe rrethanat kur kjo përgjegjësi u ngarkohet personave juridike prej veprimtarisë së të cilëve shkatohet ndotja në mjedis.

Parimi i të drejtës së mjedisit është që *ndotësi paguan*, parim ky i sanksionuar në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit i cili ka parashikuar detyrimin që ndotësi të paguajë dëmin që ka shkaktuar. Mjeti ligjor për rikuperimin e dëmit është padia për shpërblim dëmi ndaj personit që e ka shkaktuar atë.

Ndërsa si mjet ligjor për rikuperimin e dëmit të shkatuar bregdetit dhe ujrave tona detare prej anijeve të huaja që shkarkojnë lëndë dhe substanca ndotëse në to, është evidentuar Konventa Ndërkombëtare Detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, e vitit 1973”, ndryshuar me Protokollin e vitit 1978, Konventë në të cilën ka aderuar edhe shteti Shqiptar me ligjin nr.9594 datë 27.7.2006⁴⁴. Bazuar në këtë Konventë, në rastin e një krimi mjedisor shkaktuar bregdetit dhe ujërave tona detare prej anijeve të huaja, shteti shqiptar ka të drejte t’i drejtohet shtetit, flamurin e të cilit mbante anija e huaj, duke i parashtruar kërkesën për të marrë të gjitha masat penale të nevojshme për të dënuar këtë anije, për krimin mjedisor të kryer, duke i vënë në dispozicion të gjitha provat të cilat provojnë se kjo anije ka ndotur brigjet e shtetit shqiptar. Në rast se merren këto

³⁸ Shih çështjen *Öneryıldız k. Turqisë*, çështjen *Ozel dhe të tjerë kundër Turqisë*, çështjen *Careme k. Francës*, çështjen *Budayeva dhe të tjerë k. Rusisë*, çështjen *Murillo Saldias k. Spanjës*.

³⁹ Shih çështjen *Guerra dhe të tjerë k. Italisë*, çështjen *Roche k. Mbretërisë së Bashkuar*, çështjen *Brincat dhe të tjerë k. Maltës*, çështjen *Vilnes dhe të tjerë k. Norvegjisë*.

⁴⁰ Shih çështjen *L’Erablière A.S.B.L. k. Belgjikës*, çështjen *Hoëald Moor dhe të tjerë k. Zvicës*, çështjen *Karin Andersson dhe të tjera k. Suedisë*.

⁴¹ Shih çështjen *Pine Valley Developments shpk dhe të tjerët kundër Irlandës*, çështjen *Kapsalis dhe Nima-Kapsali kundër Greqisë*, çështjen *Hamer kundër Belgjikës*, çështjen *Turgut dhe të tjerë k. Turqisë*, çështjen *Satir k. Turqisë*.

⁴² Diskutime të hapura nga z. Albert Kulici, Prokuror në Prokurorinë e Tiranës.

⁴³ Në qytetin e Vlorës një anije naftëmbajtëse e huaj gjatë kohës që po mbushej me naftë, shkaktoi ndotje në të gjithë bregdetin e Vlorës, dhe për këtë shkak prokuroria nisi procedimin penal, në përfundim të të cilit u dënua kapiteni i anijes, shtetas nga Bangladeshi. Dënimet administrative që u morën nga Agjencia rajonale e mjedisit në këtë rast ishin dënime të lehta. Më tej nuk pati zhvillim. Interesi i qytetarit është që mjedisi të kthehet në gjendjen e mëparshme.

⁴⁴ Qëndrim i mbajtur nga eksperti Darjel Sina;

masa penale, të cilat gjykohen në shtetin e huaj, atëherë prej shtetit shqiptar iniciohet dhe padia civile për të dëmshpërblyer dëmin e shkaktuar ndaj bregdetit dhe ujrave detare shqiptare.

Në rastin e veprave penale mjedisore përgjegjësi civile mund të mbajë si personi fizik, pra punonjësi konkret që ka kryer veprimin kriminal, ashtu edhe personi juridik. Megjithatë kusht për përgjegjësinë civile edhe të personit juridik është që veprimi kriminal të jetë kryer në dobi apo në interes të personit juridik, pra të ketë një logjikë përfitimi për personin juridik, si rrjedhojë e veprimeve që ai ka ndërmarrë. Pra, përgjegjësia civile e një personi juridik do të varet më së shumti edhe prej anës subjektive të kryrjes së veprës mjedisore, që do të thotë se duhet hetuar se çfarë dobie i sjell personit juridik. Duhet bërë kujdes që të evidentohet se ku ka kursyer apo ka përfituar personi juridik në këto çështje që lidhen me mjedisin⁴⁵.

⁴⁵ Qëndrim i mbajtur nga eksperti znj. Elvana Cicolli.